

## Ne fokus./ Januzaj refuzon Kupon e Botes per Shqiperine?!

nga AlbaniaSoccer

E premte, 20 Shtator 2013 15:09

---



The Telegraf ka shkruar per yllin e Manchester United Adnan Januzaj duke sjelle nje lajm bombastik. Futbollisti me origjine shqiptare pritet te refuzoje Belgjiken dhe mundesine qe i jep kjo skuader per te shkuar ne Brazil veren e ardhshme. Januzaj pritet te bashkohet me Kombetaren Shqiptare duke zgjedhur origjinen e tij dhe jo Belgjiken qe po e kerkon me ngulm, duke i ofruar ne skuader nje vend titullari dhe nje mundesi per te luajtur ne kampionatin boteror. Ky lajm akoma nuk eshte konfirmuar zyrtarisht pasi menaxheri Januzaj dhe babai I tij nuk e kane treguar zgjedhjen qe do te beje futbollisti.